



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË
SEKTORI I MARRËDHËNIEVE ME BORDIN E AKREDITIMIT DHE
NDËRKOMBËTARIZIMIN

Nr. 308/5 Prot.

Tiranë, më 12 . 12 .2025

LËNDA: Përcillet vendimi i Bordit të Akreditimit

UNIVERSITETIT POLIS

Rruga Bylis 12, Autostrada Tiranë-Durrës, Km 5, Kashar,

TIRANË

Bordi i Akreditimit, në mbledhjen e tij të radhës, të mbajtur më datë 14 Nëntor 2025, mori vendime që lidhen me vlerësimin e jashtëm në kuadër të akreditimit të disa institucioneve dhe programeve të studimit.

Lutemi, gjeni bashkëngjitur, vendimin e Bordit të Akreditimit Nr. 153, datë 14.11.2025.

Gjithashtu ju bëjmë me dije se vendimi është publikuar në faqen zyrtare të internetit të ASCAL.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Anisa Subashi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË
BORDI I AKREDITIMIT

VENDIM

Nr. 153, datë 14.11.2025

PËR
AKREDITIMIN E PARË TË PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË
BACHELOR NË “ADMINISTRIM BIZNESI”, TË UNIVERSITETIT POLIS

Bordi i Akreditimit, bazuar në Ligjin Nr. 80 datë 17.09.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Ligji Nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për Funksionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”, Ligjin Nr. 44/2015, datë 30.04.2015, “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 109, datë 15.02.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 824, datë 24.12.2021, “Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”, i ndryshuar, Vendimin e Bordit të Akreditimit Nr. 2, datë 07.04.2017, “Për përcaktimin e kohëzgjatjes dhe afateve të vlefshmërisë së akreditimit në kuadër të vendimmarrjes për akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit” dhe Vendimin e Bordit të Akreditimit Nr. 224, datë 15.12.2023 “Për miratimin e Rregullores së Bordit të Akreditimit”, në mbledhjen e tij të datës 14.11.2025, në kuadër të vendimmarrjes për akreditimin e parë të programit të studimit të ciklit të parë, Bachelor në “**Administrim Biznesi**”, me të dhënat si më poshtë:

- a) Emërtimi i programit: Bachelor në “**Administrim Biznesi**”
- b) Cikli i studimit: Cikli i parë
- c) Akti zyrtar i hapjes/licensimit: Urdhër i Ministrit të Arsimit dhe Sportit Nr. 429, datë 18.07.2022
- d) Institucioni që e ofron: Universiteti Polis
- e) Njësia bazë përgjegjëse: Departamenti i Menaxhimit dhe Biznesit
- f) Kohëzgjatja (Vite/semestra): 3 vite / 6 semestra
- g) Kredite (ECTS): 180 kredite
- h) Forma e studimit: Me kohë të plotë
- i) Gjuha e mësimdhënies: Shqip
- j) Statusi i diplomës: ofrohet vetëm nga Universitetit Polis
- k) Niveli i diplomës në kuadrin e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve: Niveli 6

pasi mori në shqyrtim:

- a. Dokumentacionin e Vetëvlerësimit, përfshirë të dhënat e programit të studimit;
- b. Raportin e Vetëvlerësimit dhe dokumentacionin mbështetës;
- c. Dokumentacionin e Vlerësimit të Jashtëm, përfshirë Raportin e Vlerësimit të Jashtëm, dhe dokumentacionin shtesë;
- d. Vlerësimin e cilësisë në përmbajtje, të kryer nga ekspertët e jashtëm në përbërje të Grupit të Vlerësimit të Jashtëm;
- e. Procedurën e vlerësimit të ndjekur dhe monitoruar nga ASCAL;
- f. Komunikimin e vërejtjet e institucionit në kuadër të këtij procesi;

konstaton se:

- a. Procedura dhe procesi i vlerësimit janë kryer në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore dhe afatet e përcaktuara në këto akte;
- b. Vlerësimi në përmbajtje është i mbështetur në Dokumentacionin e Vetëvlerësimit, Vlerësimit të Jashtëm dhe gjetjet e verifikimet gjatë vizitës në institucion;
- c. Raporti është hartuar në përputhje me kërkesat dhe i mbështetur me fakte, të dhëna e dokumentacion plotësues;
- d. Rezultatet e vlerësimit janë nxjerrë në përputhje me gjetjet, pikat e forta e afirmimet dhe pikat e dobëta, të identifikuar e verifikuar përmes dokumentacionit dhe vizitës në institucion;
- e. Rezultati i vlerësimit në lidhje me shkallën e plotësimit të *“Standardeve për sigurimin e cilësisë për programet e studimeve të ciklit të parë “Bachelor”*” dhe cilësinë e ofertës akademike të programit të studimit, është **“i përmbush kryesisht standardet”**, me mangësi si më poshtë:

1. Mungesa në kurrikulën e këtij programi studimi e disa lëndëve të specializuara bashkëkohore, si Marketingu Digjital, si edhe mungesa e dokumentimit të procedurave të praktikës profesionale.
2. Format i dhe literatura e përdorur në disa prej syllabuseve të këtij programi studimi, nuk janë në përputhje me parashikimet e akteve nënligjore në fuqi.
3. Mungon integrimi i praktikave laboratorike dhe platformave digjitale në realizimin e disa lëndëve të kurrikulës së këtij programi studimi, çka kufizon zhvillimin praktik dhe teknologjik të studentëve.
4. Mungesa e një studimi të mirëfilltë të tregut të punës në funksion të këtij programi studimi, për të identifikuar kompetencat e kërkuara në tregun vendas e të huaj.
5. Mungesa e një raporti analitik mbi funksionimin e këtij programi studimi, nga njësia bazë përgjegjëse për ofrimin e tij.

Mbështetur mbi rezultatet dhe arsyetimin e mësipërm, Bordi i Akreditimit,

VENDOSI:

1. Vlerësimin përfundimtar **POZITIV** për programin e studimit Bachelor në **“Administrim Biznesi”**, të Universitetit Polis.

2. **Akreditimin** e programit të studimit me kohëzgjatjen prej **4 (katër)** vite.
3. Afati përfundimtar i vlefshmërisë së akreditimit të programit të studimit është **13.11.2029**.
4. Ngarkohet Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë për zbatimin e këtij vendimi, publikimin dhe lëshimin e certifikatës së akreditimit brenda një muaji nga data e marrjes së këtij vendimi, si dhe monitorimin për ruajtjen në vijim të Standardeve të Kodit të Cilësisë dhe plotësimin e rekomandimeve sipas shtojcës bashkëlidhur.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


BORDI I AKREDITIMIT

SHQIPONJA TELHAJ



Kryetare

TOMASZ JELENSKI



Anëtar

MAURICE OUDEJANS



Anëtar

IRAJ HASHI




Anëtar

INDRIT HOXHA



Anëtar

DARINKA PIQANI



Anëtar

DRITAN NAÇE



Anëtar

MIRJETA BEQIRI



Anëtar

NIKOLLA QAFOKU



Anëtar

KITA SALLABANDA DIAZ



Anëtar

LORETA KONDILI



Anëtar

Shtojca

Rekomandimet në zbatim të vendimit të Bordit të Akreditimit Nr. 153, datë 14.11.2025, “Për akreditimin e parë të programit të studimit Bachelor në **“Administrim Biznesi”**, të **Universitetit Polis**, janë si vijon:

1. Institucioni, të rishikojë kurrikulën dhe syllabuset e këtij programi studimi në përputhje me parashikimet e akteve nënligjore në fuqi, duke marrë parasysh rëndësinë e lëndëve në mjedisin aktual, përfshirjen e lëndëve të reja, standardizimin e mënyrës së paraqitjes dhe informacionit për secilën lëndë, përcaktimin e saktë të numrit total të orëve mësimore, si dhe integrimin e praktikës laboratorike dhe platformave digjitale në zhvillimin e disa lëndëve.
2. Institucioni, të kryejë një studim të mirëfilltë të tregut të punës në funksion të këtij programi studimi, për të identifikuar kompetencat e kërkuara në tregun vendas e të huaj.
3. Institucioni, nëpërmjet njësisë bazë përgjegjëse për ofrimin e këtij programi studimi, të hartojë raporte analitike periodike, mbi funksionimin e programit të studimit.

Në përmbushje të rekomandimeve të mësipërme, **Universiteti Polis**, duhet të hartojë një Plan Veprimi konkret dhe ta dorëzojë atë brenda 2 (dy) muajve pranë Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë.

Ngarkohet ASCAL për ndjekjen e përmbushjes së këtyre rekomandimeve dhe raportimin në BA brenda afatit të përcaktuar në Planin e Veprimit.

